



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 29 qershor 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Ahmet Isufi, Avdullah Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Faton Topalli, Valon Ramadani, Verica Çeraniq, Ali Lajçi dhe Zafir Berisha.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

Pjesëmarrësit tjerë: Fatmir Gashi, Kosum Aliu, Kimete Arifi – MF, Safet Berisha –ZKA, Sali Zyba- LVV, Shqiponjë Osmanaj- RTK, Aurora Buqaj- KDI dhe Aldisa Morina-AAK.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 5.6.2018 dhe 12.6.2018;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimeve nga raporti i auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Pejë për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit dhe e hapi mbledhjen

sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi e procesverbalet të mbledhjeve të mbajtura më 5.6.2018 dhe 12.6.2018;

Procesverbalet e mbledhjeve së mbajtura më 5.6.2018 dhe 12.6.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimeve nga raportit të auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Pejë për vitin 2017;

Driton Selmanaj, kryetar, njoftoi se administrata ka përgatit një rekomandim për Ndërmarrjen Drini i Bardhë SH.A edhe atë: Bordi i Drejtorëve së bashku me kryeshefin e Ekzekutivit të KRU Drini i Bardhë SH.A, t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura për adresimin e të gjitha rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit për PVF-të e kompanisë Drini i Bardhë, për vitin 2017. Për këtë të raportojë me shkrim në baza tremujore tek aksionari si dhe në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që raporti i Auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Pejë, për vitin 2017, të mos adresohet për seancë plenare. Megjithatë, rekomandimi t'i adresohet menxhmentit të Kompanisë Drini i Bardhë SH.A.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017;

Kryetari, njoftoi se Qeveria e ka dorëzuar raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017. Me këtë hapi diskutimin.

Fatmir Gashi, paraqiti raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017. Ministria e Financave së

bashku me Njësinë Qendrore të Harmonizimit, harton raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit e brendshëm të financave publike në sektorin publik për vitin 2017, në zbatim të ligjit të financave publike dhe përgjegjësit si dhe ligjit për auditorin e brendshëm, raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik, është një përmbledhje e rezultateve të arriturave gjatë vitit 2017 në fushën e menaxhimit të financave dhe kontrollit si dhe auditimit të brendshëm në nivel qendror dhe në atë lokal. Krahasuar me vitin e kaluar, aktivitetet e Njësisë qendrore të harmonizimit, gjetjet, konkluzionet dhe çështjet për adresim në të ardhmen, në lidhje me menaxhimin e financave, kontrollin dhe auditimin. Të arriturat gjatë vitit 2017 të kontrollit të brendshëm të financave publike konsistojnë në implementimin e strategjisë për kontrollin e brendshëm të financave publike, konkretisht në përmirësimin e infrastrukturës ligjore të kontrollit të brendshëm të financave publike, ngritjen e përgjegjësisë menaxheriale për të krijuar një sistem të shëndosh.

Avdullah Hoti, fillimisht përgëzoi për progresin e në veçanti për certifikimin e auditorëve të brendshëm nëpër institucione publike. Besoj që është standardizuar plani dhe programi si duket edhe në raport, organizatat janë të mbuluara si duhet. Me Ligjin e kontrollit brendshëm implikimet që rrjedhin prej institucioneve. Ku keni mbërrirë me nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe në atë që derivojnë prej këtij ligji. Tek Njësitë e auditimit të brendshëm të cilat në vitin 2017 kanë kryer 497 auditime, tash si numër është bukur i lartë. Ka një ngritje të vogël nga viti 2016. Më intereson, se si po i përzgjedhin njësitë e auditimit të brendshëm, auditimet që i bëjnë, a ka ndonjë analizë të riskut të standardizuar nga njësia juaj që i udhëzon ata se cilat auditime të kryhen brenda një organizate të caktuar.

Ka organizata që nuk e kanë fare Njësinë e auditimit brendshëm, disa për arsye politike si veriu i Mitrovicës, Zubin Potoku, Zveçani, po disa tjera, siç janë Mamusha, Hani i Elezit, Kllokoti, Parteshi. A ka ndonjë arsye specifike, a keni biseduar me ato Komuna?

Tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, që ka 22 milionë euro gjatë vitit 2017, s'ka pas fare plan vjetor të auditimit të brendshëm, e as raport vjetor të punëve të kryera. Çka ka ndodhur me Ministrinë? Kur ka 22 milionë euro pa njësi të auditimit brendshëm, pa plan vjetor të auditimit të brendshëm?

Kosum Aliu, theksoi se sa i përket udhëzimeve administrative, kanë qenë si drafte edhe para implementimit të Ligjit po për shkak formaliteteve, është dashtë të krijohen grupe punuese në kuadër të Ministrisë së Financave dhe nga gjithë aktorët që janë të përfshirë, organizatat buxhetore, nivelet komunale dhe tash jemi në fazën të përfundimit të 3 udhëzimeve kyçe që ndihmojnë implementimin e Ligjit të kontrollit brendshëm të financave publike.

Sa i përket çështjes së auditimeve, janë kryer 497 auditime, çdo vit para fillimit të vitit, deri më 31 tetor, çdo organizatë buxhetore, apo njësi e auditimit të brendshëm, duhet të hartojë një plan vjetor dhe një plan strategjik trevjeçar për veprimet që duhet t'i ndër marrë gjatë afatit të përcaktuar. Paraprakisht bëhet një analizë dhe çdo organizatë ju drejtohet të gjitha departamenteve. Kërkesa që ato si departamente të ministrisë përkatëse, të identifikojnë risqet e mundshme, që ne si auditor të brendshëm të fokusohemi në atë pjesën e risqeve. Për këtë mungesë, kemi alarmuar organizatat buxhetore që të reflektojnë konform ligjit, që të formojnë

njësinë e auditimit. Është një udhëzim administrativ që përcakton kriteret, kush dhe sa auditorë duhet të ketë. Çdo organizatë buxhetore, që ka pasur buxhet mbi 5 milion euro dhe më tepër se 50 të punësuar, ka qenë e obliguar që të ketë një njësi të auditimit prej 3 auditorëve. Në këtë kontekst e kemi një vërejtje nga Komisionit Evropian, që kemi njësi të auditimit me një auditor, e që nuk është sipas standardeve të kërkuara.

Mërgim Lushtaku, tha se sa i përket akteve nënligjore, a i keni identifikuar sipas ligjit të kontrollit të brendshëm të financave publike? Pastaj, tek çështja e certifikimit të auditorëve, sa auditorë janë gjithsej në qeverisjen qendrore dhe në atë lokale? Me çfarë kriteri mbahet në punë si auditor, a ka ndonjë periudhë të caktuar që të pajiset me certifikatë nga ndonjë trajnim?

Kryetari, theksoi se sipas informatave që kam, keni rekrutuar 5 auditorë, të cilët nuk janë të pacertifikuar, pse ndodhë që ata të certifikuarit të mbesin jashtë e këta të pacertifikuarit të pranohen, e pastaj të i nënshtrohen certifikimit. A i monitoroni këto procese?

Sali Zyba, tha se duke filluar nga menaxhimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ju cituat se nuk është marrë masa për auditor, ndërsa ju zv.ministër theksuat se duhet krijuar mekanizëm dënues. Cilat janë masat që keni ndërmarrë ju si Ministri e Financave? A keni ndonjë mekanizëm dënues sepse po bëhet fjalë për një Ministri të Zhvillimit Ekonomik?

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raporti i auditimit për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017, të adresohet në seancë plenare. Rekomandimet për këtë do të aprovohen në Mbledhjen e radhës së Komisionit..

5. Të ndryshme

Driton Selmanaj, kyetar, njoftoi deputetët se në mbledhjen e radhës së KMFP-së, do të bëhet shqyrtimi i rekomandimeve për raportin vjetor, për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në Kosovë, për vitin 2017, si dhe shqyrtimi i raportit të performancës për ZKA-në, për vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Driton Selmanaj